DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-951/1
-III-
Data Datum Date 29.07.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 24.07.2013
Nr. 0204-951

**PËR:** Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, 01 Nr. 046-112222 Pranuar me datë, 15.07.2013.**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 046-112222 të miratuar me datë 28.06.2013, ***KONFIRMON*** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01Nr.046-112222, për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim peronave fizikë/juridik.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALĖSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-951/1
-III-
Data Datum Date 29.07.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

---

Datum: 24.07.2013
br. 0204-951

**Za:** Isa Mustafa, Gradonačelnik opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine opštine Priština

**Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Priština 01 br. 046-112222** primljeno dana **15.07.2013.**

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim adminstativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br. 046-112222 odobreno dana 28.06.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01br.046-112222, o usvajanju predloga gradonačelnika opštine o usvajanju odluke za davanje nepokretnog opštinskog zemljišta pravnim ili fizičkim licima.

Sa poštovanjem.

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*
*Arhivi MALS-a.*

16.07.2013 Printoj

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 15.07.2013
-III- 024-351

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe të nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare Republikës se Kosovës ", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 7, paragrafi 3 i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës " nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës se Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2012, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.6.2013, miratoi ketë

**VENDIM**

I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizikë/ juridikë.

II. Sipas vendimit të cekur në pikën I, prona e paluajtshme në vijim do të jepet në shfrytëzim:
Parcela kadastrale nr. P-71914059-06191-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 9628 m$^2$, në pronësi të Komunës.

III. Arsyet dhe qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, janë ushtrimi i veprimtarisë së biznesit - parkimi i automjeteve.

IV. Afati kohor për dhënien e pronës, të cekur në piken II të këtij vendimi, është afatshkurtër, në periudhën për 5 vjet.

V. Komuna e Prishtinës ruan të drejtën që, sipas nevojës, për realizimin e interesit publik te Komunës, të ndryshojë kohëzgjatjen e shfrytëzimit të cekur në vendim.

VI. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës, organi kompetent për pronë dhe organi kompetent për regjistrimin e pronës së paluajtshme.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 046-112222, më 9.7.2013

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.

Adresa: Rr. UCK- 2- 10 000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org